

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arbëreshët e Siçilisë: një identitet shekullor që po zbehet
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/27/arbereshet-e-sicilise-nje-identitet-shekullor-qe-po-z-behet/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 05:32:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 05:18:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f8f33c6bb98e2a88c8125e43f5807b3782f441b2b0979e9aba65c9c86be7409a
TEKSTI	b299fd790e2fa64f014f8fbdb12aad27d2e97ac727f54eeb6140a020259fa459
PAMJA	63484e3856f74d4c863b4d1d774e818048a0dc8f5c5bf19c42367235ae62bf66

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9af5cc2b846ebc206282232337332f07f88ad87dda622f1238f866f7258fc7ea
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2da1c98ea07c52336cef3545e92b1a3ac1fae14de43d5323995db89b2f01bad6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9af5cc2b846ebc206282232337332f07f88ad87dda622f1238f866f7258fc7ea>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Reportazhe

Arbëreshët e Siçilisë: një identitet shekullor që po zbehet

Ndryshimet klimatike, humbja e vendeve të punës dhe emigrimi kërcënojnë të ardhmen e komunitetit shekullor arbëresh në ishullin italian të Siçilisë.



nga Stefania D'Ignotti — 2 minutes më parë në Artikull kryesor, Reportazhe

Koha e leximit: 11 min lexim

AA

0



Giorgio Cuccia duke folur gjatë një procesioni kulturor arbëresh gjatë Javës së Pashkëve në Piana degli Albanesi. Foto: kortezi nga Giorgio Cuccia.

Rruga e ngushtë dhe e amortizuar rurale që të çon drejt fermës organike Officine Kaggjotto, në periferi të Piana degli Albanesi në Siçili, përshkon kodrat 24 kilometra në jug të Palermos, kryeqytetit të ishullit.

Gjatë rrugës shfaqen tabela dygjuhëshe, në italisht dhe në një formë të lashtë të shqipes. Për një çast, peizazhi të ngjan më pak me Siçilinë dhe më shumë me një enklavë të huaj.

Në fermë, vëllai dhe motra Claudio Scalia, 33 vjeç, dhe Chiara Scalia, 29 vjeç, kujdesen për 50 hektarë me ullinj dhe koshere bletësh. Produkteve të tyre u kanë vënë emra të marrë nga gjuha e lashtë shqipe që flisnin paraardhësit e tyre dhe që ata ende e flasin.

Edhe pse mbiemri i tyre është italian, kjo nuk ishte gjuha me të cilën u rritën.

Të dy janë pjesë e rreth 100,000 arbëreshëve në Itali, një pakicë etnike shqipfolëse që jeton në rajonet jugore të Italisë prej rreth pesë shekujsh. Por sot e ardhmja e këtij komuniteti është e rrezikuar: ndryshimet klimatike po godasin tokat e tyre bujqësore, emigrimi po rritet dhe mundësitë për punësim janë të pakta.

"Nuk duam të fshihemi nga historia, sepse kjo do të nënkuptonte humbjen përgjithmonë të një pjese të rëndësishme, por të lënë pas dore, të historisë evropiane," tha Claudio për Balkan Insight. "Po luftojmë çdo ditë për mbijetesën tonë, me të gjitha mjetet që kemi."

Pesë shekuj në Siçili



Claudio Scalia dhe Chiara Scalia, të cilët drejtojnë fermën organike Officine Kaggjotto. Foto kortezi nga Claudio

Arbëreshët e Siçilisë: një identitet shekullor që po zbehet

07:18 | 27/09/2026

Kur populli e bojkoton shkrimtarin, para se shkrimtari të bojkotojë popullin

14:44 | 26/09/2026

Republika e sofizmave

08:03 | 26/09/2026

Zgjidhen tre anëtarët e rinj gjyqtarë të KLGJ-së

20:07 | 25/09/2026

Organizatave e medias denoncojnë sjelljen e policisë ndaj gazetares së Citizens.al

15:12 | 25/09/2026

Mjedisorët dërgojnë në Kushtetuese vendimin që zhveshi nga mbrojtja Pishë Poro-Nartën

13:37 | 25/09/2026

Arbëreshët janë pasardhës të shqiptarëve që emigruan në Itali në valë të ndryshme midis shekujve XV dhe XVIII, pas zgjerimit të Perandorisë Osmane në Ballkan.

Shumë prej atyre që mbërritën në Sicili erdhën pas vdekjes së heroit shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në vitin 1468, dhe rënies së qëndresës që ai kishte udhëhequr kundër osmanëve.

Sipas traditës gojore të komunitetit, familje të tëra kaluan detet Adriatik dhe Jon me varka të vogla prej druri, përpara se të themelonin vendbanime në të gjithë Italinë e Jugut.

Ata mbërritën në një tokë që më vonë do të bëhej pjesë e Italisë së sotme, por nuk hoqën dorë nga gjuha, zakonet dhe traditat e tyre fetare.

Sot, komunitetet arbëreshe janë të shpërndara në të gjithë Italinë e Jugut, nga Sicilia në Kalabri, Bazilikatë, Pulia, Kampania dhe Molize.

Në Sicili, rreth pesë vendbanime historike vazhdojnë të ekzistojnë në kodrat në jug të Palermos, por Piana mbetet qendra kryesore kulturore e komunitetit.

Emri i saj – i ndryshuar në "Piana dei Greci" ("Lugina e grekëve"), për shkak të traditave të saj fetare bizantine, gjatë regjimit të Musolinit – u rikthye pas Luftës së Dytë Botërore në emrin origjinal "Piana degli Albanesi" ("Lugina e shqiptarëve").

Fakti që ata kanë mbijetuar për shekuj është i jashtëzakonshëm, por e ardhmja e tyre është shumë më e pasigurt. Shpopullimi, zhdukja e vendeve tradicionale të punës në zonat rurale, dobësimi i përcjelljes së gjuhës arbërisht dhe presionet gjithnjë e më të mëdha të ndryshimeve klimatike po përplasen mbi komunitete që prej brezash përipiqen të ruajnë një identitet të brishtë.

Claudio Scalia e di mirë se ç'është të thotë të largohesh.

Disa vite më parë, ai u largua nga Piana dhe u vendos në jug të Spanjës për të nisur një jetë të re larg vendlindjes, si mijëra siciliane të tjerë gjatë dekadave të fundit. Por më pas u kthye, thotë ai, pjesërisht nga malli dhe pjesërisht sepse donte të kontribuonte në ringjalljen e komunitetit të tij.

"Jemi rritur si fermerë dhe gjithmonë e kemi identifikuar veten si të tillë, por ky identitet po zhduket bashkë me ne," tha ai. "Prandaj është e rëndësishme t'ua përcjellim të rinjve dhe të mbajmë gjallë traditat tona."

Për të, bujqësia nuk është thjesht një veprimtari ekonomike. Ajo është pjesë e identitetit që i ka bërë arbëreshët ata që janë.

Kujtesë të një versioni të "lashtë" të Shqipërisë



Rosario Petta (në qendrë, duke folur), kryebashkiaku i Piana degli Albanesi, gjatë një mbledhjeje javore të këshillit bashkiak. Foto kortezi nga Rosario Petta.

Piana degli Albanesi shtrihet mes maleve pjellore të Sicilisë Perëndimore, me pamje nga tokat bujqësore dhe një liqen, niveli i ujit të të cilit është ulur ndjeshëm.

Emri i saj arbëresh është "Hora e Arbëreshëve", ose "Qyteti i arbëreshëve", i vetmi ndër disa qytete të tjera italiane që ka ruajtur një emër të veçantë të lidhur me grupin etnik që banon aty.

Fjala "Hora", shpjegon kryebashkiaku Rosario Petta teksa ecën nëpër rrugët me kalldrëm të qytetit, është një fjalë e vjetër shqipe për qytetin ose vendlindjen, që nuk përdoret më gjerësisht në shqipen e sotme.

Në Piana, megjithatë, emri është kudo. Shfaqet në tabelat e rrugëve, në ndërtesat publike dhe në bizneset lokale, duke kujtuar se ky nuk është thjesht një qytet sicilian me një histori të veçantë. Është qendra e një prej komuniteteve më të rëndësishme etnolinguistike të Italisë.

Petta thotë se në Shqipëri arbëreshët shihen pothuajse si figura mitike – si kujtesë e një versioni të Shqipërisë që u zhduk shekuj më parë, por që vazhdon të jetojë në këto komunitete.

Mes dy anëve ekziston një marrëdhënie historike e pazakontë.

Banorët e Pianës e shohin Shqipërinë si tokën e të parëve, prej së cilës u krijuan komunitetet e tyre. Ndërkohë, në Shqipëri, arbëreshët përfaqësojnë një lidhje të gjallë me një formë më të hershme të gjuhës dhe kulturës shqiptare, të cilën në vendin e tyre të origjinës nuk mund ta përjetojnë më.

Por komuniteti i Pianës po tkurret.

Gjatë pesë viteve të fundit, sipas Petta-s, qyteti ka humbur më shumë se 20 për qind të popullsisë. Popullsia zyrtare tani është nën 6,000 banorë, megjithëse besohet se numri real i njerëzve që jetojnë aty është edhe më i ulët.

"Sa më shumë njerëz humbasim, aq më shumë kërcënohet trashëgimia jonë e lashtë", tha Petta.

Arsyet janë të njohura në të gjithë Italinë e Jugut rurale: mundësitë e kufizuara për punësim, largimi i të rinjve drejt qyteteve më të mëdha ose jashtë vendit dhe rënia e bujqësisë tradicionale.

Në Piana, ndryshimet klimatike po i shtojnë një tjetër shtresë kësaj krize.

Ullishtat përreth Pianës po përballen gjithnjë e më shumë me thatësi, temperaturat ekstreme dhe zjarret.

Në vitin 2023, zjarret shkatërruan disa hektarë tokë përreth qytetit. Edhe kriza e ujit po i prek drejtpërdrejt fermerët.

"E kemi ndier shumë krizën e ujit dhe kjo reflektohet në sasinë, cilësinë dhe kohën e prodhimit tonë", tha Claudio.

Vjeljet janë zhvendosur më herët, ndërsa verat po bëhen më të gjata dhe më të nxehta. Pemët po shfaqin shenja stresi që më parë ishin të pazakonta.

"Stina e verës është më e gjatë", shtoi ai. "Këtë vit, vjelja e rrushit nisi më herët për shkak të ndryshimeve të motit."

Prandaj, kriza klimatike kërcënon më shumë sesa ferat individuale. Bujqësia ka qenë historikisht një nga mënyrat përmes të cilave komunitetet arbëreshe kanë ruajtur lidhjen me fshatrat e tyre dhe janë integruar në shoqërinë italiane dhe shqiptare. Nëse bujqësia bëhet ekonomikisht e paqëndrueshme, zhduket edhe një nga arsyet e mbetura që të rinjtë të qëndrojnë.

Vëllai dhe motra Scalia po përpiqen ta bëjnë bujqësinë pjesë të zgjidhjes.

Kompania e tyre u themelua në vitin 2022, duke u mbështetur mbi një ullishte të mbjellë në vitin 1998. Synimi i tyre është të ndërthurin praktikat moderne bujqësore me trashëgiminë kulturore të Pianës.

Produktet e tyre janë organike dhe, në planin afatgjatë, synojnë të sigurojnë një certifikim të origjinës territoriale, siç është përcaktimi IGP. Përveç vajit të ullirit, ata prodhojnë mjaltë dhe produkte të tjera bujqësore, përfshirë kumbullat.

Emrat e produkteve të tyre i bëjnë homazh trashëgimisë arbëreshe. Njëri prej tyre, "Filari", i referohet rreshtave të ullinjve, ndërsa sjell ndër mend "fili d'oro", fijet e arta të përdorura në veshjet tradicionale arbëreshe.

Qëllimi është ta bëjnë më të dukshme lidhjen mes bujqësisë dhe kulturës.

"Pak njerëz investojnë sot në bujqësi dhe inovacion", tha Claudio Scalia. "Ata që e bëjnë këtë e kanë të vështirë të jetojnë vetëm nga bujqësia. Për ta mbajtur gjallë kulturën tonë bujqësore, po merremi edhe me punë të tjera, në mënyrë që të sigurojmë një bazë financiare më të qëndrueshme."

Fëmijët nuk e flasin më gjuhën





50 hektarët e tokës bujqësore organike të Officine Kaggliotto, parë nga lart. Foto kortezi nga Officine Kaggliotto.

Nëse bujqësia është themeli fizik i komunitetit, gjuha është themeli i tij kulturor më i brishtë.

Arbërishtja ka mbijetuar për shekuj në fshatrat e Italisë së Jugut, duke u zhvilluar më vete nga shqipja moderne dhe duke përthithur ndikime nga italishtja dhe dialektet vendase.

Por përcjellja e saj nga një brez te tjetri po dobësohet.

"Gjuhët ruhen nga prindërit, përmes lidhjeve familjare që përcillen nga një brez te tjetri", tha Giorgio Cuccia, 67 vjeç, president i Pro Loco-s së Pianës, një shoqatë që mbështet veprimtaritë kulturore të qytetit. "Kur nuk fliten më, ato humbasin."

Kisha ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e gjuhës dhe identitetit të komunitetit, shtoi Cuccia.

Kishat në Piana janë katolike, por përdorin ritin bizantin, një tjetër element i rëndësishëm i trashëgimisë arbëreshe. Ceremonitë fetare, himnet dhe festat kanë ndihmuar në ruajtjen e një gjuhe dhe traditash që përndryshe mund të ishin zhdukur.

Por brezi i ri po largohet gjithnjë e më shumë nga gjuha.

"Grupmosha nga pesë deri në 20 vjeç nuk e flet më", tha Cuccia.

Të rinjtë mund të hasen me arbërishten në shkollë ose gjatë veprimtarive fetare dhe kulturore, por kjo është ndryshe nga përdorimi i saj natyreshmë me miqtë dhe familjarët.

Edhe koha që i kushtohet mësimi të gjuhës është e kufizuar, tha ai, ndërsa numri i mësuesve që janë në gjendje ta mësojnë atë mbetet i pamjaftueshëm.

Ky dallim është i rëndësishëm, sepse një gjuhë që mësohet si lëndë mund të ruhet për njëfarë kohe. Një gjuhë që flitet në shtëpi bëhet pjesë e jetës së përditshme dhe mund të mbetet e gjallë.

"Ne nuk flasim siçilisht", tha Cuccia. "Por vendi im nuk është as Shqipëria, edhe pse ata na shohin si patriotë."

Është një përshkrim i përmblodhur i dilemës arbëreshe. Ata nuk janë shqiptarë që jetojnë në Itali në kuptimin tradicional. Janë një pakicë italiane, historia e së cilës është shqiptare.

Po bëhen përpjekje që kjo histori të mos shndërrohet thjesht në folklor. Teatri dhe nisma të tjera kulturore po përdoren për të tërhequr banorët e rinj, megjithëse organizatorët thonë se mbetet e vështirë t'i bindësh të rinjtë se trashëgimia e tyre mund t'u ofrojë një të ardhme, dhe jo vetëm një lidhje me të shkuarën.

Alessandra Lo Cascio, 30 vjeç, po organizon workshop-e si anëtare e Zgjimit, një grupi lokal teatror që vë në skenë vepra të njohura në arbërisht, me synimin për ta mbajtur gjuhën gjallë në ndërveprimet e përditshme dhe për t'i nxitur të rinjtë të kthehen në Piana të paktën një herë në javë për ta praktikuar atë, me shpresën se kjo mund t'i motivojë të rikthehen përfundimisht.

"Është më shumë se thjesht një hobi; është një mjet që na ndihmon të mbijetojmë", tha Lo Cascio.

Petta po ndjek një tjetër qasje: turizmin.

Ndërsa turizmi masiv po ndikon gjithnjë e më shumë në Sicili, qytetet rurale në brendësi të ishullit, të cilat kanë nevojë për përfitimet ekonomike të turizmit, shpesh mbeten jashtë vëmendjes. Piana tashmë ka një kalendar festash që ofrojnë një shprehje jashtëzakonisht të gjallë të identitetit arbëresh.

Çdo 30 gusht, qyteti përkujton themelimin e tij në shekullin XVI. Gjatë vitit zhvillohen edhe festime të tjera të rëndësishme, përfshirë festën e prillit të Shën Gjergjit, kremtimet e Pashkëve sipas ritit bizantin dhe dasmat tradicionale, në të cilat nuset veshin kostume shekullore të zbukuruara me fije ari dhe mbulesa koke të qëndisura me ornamente.

Këto veprimtari po tërheqin gjithnjë e më shumë vizitorë nga jashtë Sicilisë, veçanërisht nga Ballkani. Sipas Petta-s, këtë prill rreth 400 turistë udhëtuan posaçërisht drejt Pianës për festën e Shën Gjergjit. Shumë prej tyre erdhën nga zona të tjera të Italisë, si edhe nga Shqipëria dhe Kosova.

Numri ishte ndjeshëm më i lartë se në vitet e mëparshme. Për Pianën, kjo ka rëndësi.

"Për herë të parë në pesë shekuj, këto qytete po i ftojnë hapur shqiptarët dhe kosovarët të vijnë e të shohin se çfarë ka mbetur prej nesh këtu", tha Petta.

Gjuha dhe traditat që dikur i dallonin arbëreshët nga fqinjët e tyre po bëhen tani baza për të tërhequr vizitorë.

Shqiptarët "u kanë një borxh"



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.